



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_955\_06\_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 27.06.2013

**në seancën e mbajtur më datë 06 shtator 2013, nxorri këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHE**t ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin J.Gj. (shifra e konsumatorit: DPR – 16173) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_955\_06\_13 i datës 05.06.2013.

**Arsyetim**

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 11.12.2012 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 16173, dhe kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 32780079 me gjendje TL= 51369 kW (tarifa e lartë) dhe TU= 43667 kW (tarifa e ulët), si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 62274464 me gjendje: TL=000000 kW dhe TU=000000 kW.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 03.02.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën e energjisë elektrike për muajin 01/2013 me shpenzim prej 2712 kWh, apo e shprehur në vlerë financiare 253.27 €.

Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë ndaj faturës së energjisë elektrike të muajit 01/2013 për shkak të leximit jo të saktë. Pas ankesës së konsumatorit punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 01.03.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit DPR – 16173, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 62274464: TL= 002821 kW dhe TU= 001127 kW.

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 11.02.2013 iu është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij bazuar në listat e leximit, pasqyrën e shpenzimit dhe procesverbalin nr. 0162798 datë 11.12.2012 si dhe ka bërë korrigjimin në vlerë (-44.69€).

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut me datë 22.03.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka shqyrtimin e ankesës dhe me datë 05.06.2013 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që: 1) të shkarkoj shifrën DPR - 16173 nga korrigjimi numër 47768DPR-16173 të



datës 03.03.2013; 2) të korrigjoj faturën 01130DPR-16173 (fatura e muajit 01/2013) duke bërë shpërndarjen e kWh (të regjistruar në listën e leximit për periudhën 01/2013) për periudhën dy mujore (12/2012 dhe 01/2013); dhe 3) të korrigjoj faturat për periudhën 01/2012 deri më 12/2012 duke bërë shpërndarjen e kW (të regjistruar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit).

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 28.06.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është se shërbimi i faturimit ka faturuar me një gabim të vogël dhe i cili gabim është përmirësuar me datë 11.02.2013. Po ashtu në ankesë të KEDS-it theksohet se KEK-u ka korrigjuar faturat 01/2012, 04/2012, 11/2012 dhe 12/2012 – 01/2013 në vlerë prej (-44.69€).

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 09 shtator 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se Departamenti i faturimit në KEK me datë 03.02.2013 e ka faturuar konsumatorin për shpenzimet mujore për periudhën 01/2013 prej 2712 kWh apo shprehur në vlerë financiare 253.27 €. Po ashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalet e KEK-ut nr. 0162798 të datës 11.12.2012 në të cilën është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe procesverbalin e inspektimit nr. 1917969 të datës 01.03.2013, për të verifikuar gjendjen e njehsorit elektrik me njehsor të vjetër elektrik nr. 32780079 dhe njehsorit të ri nr. 62274464.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike dhe faturimit të energjisë elektrike për muajin 01/2013 ka vërejtur se Departamenti i Faturimit në KEK ka gabuar me këtë faturë të këtij muaji pasi që kilovatorët e regjistruar me njehsorin elektrik nr. 62274464 nga periudha 11.12.2012 e deri më 01.02.2013 i ka faturuar si shpenzim mujor, ndërsa është dashur që këtë shpenzim të grumbulluar të shpërndaj ndaras për periudhën dy mujore (12/2012 dhe 01/2013), si dhe diferencë e shpenzimit në mes periudhës 11.12.2012 dhe periudhës 11/2012 me njehsorin e vjetër.

Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike ka vërejtur se ka lexim të rregullt por jo të saktë të shpenzimeve të energjisë elektrike në tarifën e ulët nga periudha 10/2009 dhe rrjedhimisht shpenzimet e regjistruar në tarifën e ulët nuk përputhën me shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit. Sipas energjisë aktive të regjistruar në CCP gjendja e shpenzimeve për periudhën 12/2012 është TL= 51369 kW kurse TU= 44217 kW, ndërsa në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 1917969 datë 11.12.2013 është TL= 51369 kW dhe TU= 43667 kW e që paraqet një ndryshim prej 550 kW në tarifën e ulët, dhe se gjendja e tarifës së ulët TU=43367 kW nuk ka ndryshuar që nga periudha 12/2008. Po ashtu është vërejtur se Departamenti i Faturimit në KEK gjatë vitit 2012 në disa muaj e ka faturuar konsumatorin pa matje/paushall madje edhe në ankesën e KEDS-it drejtuar Bordit të ZRRE-së ka theksuar se korrigjuar faturat 01/2012, 04/2012 dhe 11/2012 pasi që janë faturuar pa matje/paushall. Bordi i ZRRE thekson se leximi dhe faturimi i energjisë elektrike për konsumatorët duhet të bëhet sipas Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Procedurës së Leximit dhe Faturimit, pra për çdo muaj, andaj për shkak të gabimeve të bëra rreth faturimit pa matje/paushall të konsumatorit gjatë vitit 2012 Departamenti i Faturimit në KEK-u (tani KEDS) duhet të shpërndarjen e këtyre kilovatorëve nga fatura e muajit 01/2012 e deri në procesin e regjistrimit të njehsorit elektrik 12/2012.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEDS në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 06.09.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_955\_06\_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar